



DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE

PLANI STRATEGJIK

2012 - 2015

Tiranë, nëntor 2011

Mesazhi

i

Drejtorit të Përgjithshëm

Të nderuar tatimpagues,

Administrata tatimore e ka përgatitur planin strategjik afatmesëm për periudhën 2012-2015, duke u mbështetur tek temat e zhvilluara në strategjinë e mëparshme. Ky plan i ri, i cili shtjellohet në këtë dokument do të na orientojë në punën tonë për katër vitet e ardhshme.

Me prioritetet e rëndësishme që përmban, Plani Strategjik u dëshmon të gjithëve se DPT-ja është e aftë për ta arritur misionin e saj. Ne do të ecim përpara, në pesë qëllimet kryesore dhe në faqet e këtij plani shpjegohet se si do ta arrijmë këtë. Subjektet që kryejnë evazion fiskal do të përballen me një mjedis më të vështirë, me rritje të mundësisë për t'u zbuluar dhe ndëshkuar.

Shumica e tatimpaguesve, të cilët normalisht veprojnë në pajtueshmëri me legjislacionin tatimor do të përfitojnë edhe më shumë nga përmirësimi në vazhdim i shërbimeve tona. Mbetemi të angazhuar për edukimin e tatimpaguesve, të cilin do ta zgjerojmë përmes përgatitjes së të rinjve në lidhje me detyrimet tatimore që i presin më vonë në jetë. Mirëpo, mënyra më e mirë e edukimit të tatimpaguesve është të tregojmë përmes veprimeve tona se DPT-ja është në gjendje ta përmbushë misionin e saj në mënyrë të drejtë dhe të efektshme, në favor të gjithë shqiptarëve.

Tatimpaguesi, i cili i përmbush detyrimet e veta, nuk ka asnjë arsye përse të frikësohet nga veprimtaria jonë. Ne do të bashkëpunojmë me të gjithë përfaqësuesit e komunitetit të tatimpaguesve dhe shoqatat dhe institucionet ligjore të tyre, në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohej gjatë zhvillimit të sistemit tatimor.

Katër vitet e fundit kanë shënuar një periudhë shumë të rëndësishme në jetën e sistemit tatimor në Shqipëri. Cilësia e shërbimeve tona është rritur edhe më tej, me hapjen e qendrave të reja bashkëkohore që ka krijuar një përvojë pozitive të shërbimeve në Tiranë dhe do të vijojë edhe në qendrat e mëdha urbane. Ka filluar dhe funksionon deklarimi elektronik i tatimeve për bizneset, ndërsa është përmirësuar kapaciteti ynë për të evidentuar subjektet që mund të kryejnë evazion fiskal.

Më poshtë, paraqiten planet ambicioze për reformim të mëtejshëm. Ndër këto plane, përfshihet modernizimi i strategjisë së pajtueshmërisë, përmes së cilës synojmë të ndëshkojmë me forcën e ligjit të gjithë ata që nuk pajtohen me zbatimin vullnetar të legjislacionit apo kanë një kundërshtim të zbatimit, që shkon në nivelet e evazionit atyre. Do ta përmirësojmë mbledhjen e borxhit tatimor dhe do të vazhdojmë ta zhvillojmë edhe më tej Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj. Duhet përbushur edhe prioritetet e qeverisë, në fushën e tatim-taksave, ku përfshihet edhe futja për herë të parë e deklarimit të tatimeve nga individët. Në misionin tonë do të na ndihmojë edhe përmirësimi i teknologjisë së informacionit. Është e rëndësishme të ecim përpara me reformën dhe në këtë plan strategjik përshkruhet se si do ta bëjë këtë DPT-ja.

Përmirësimet e planifikuara në administratën e tatimeve, janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit fiskal afatgjatë, rritjen e aktivitetit ekonomik të vendit dhe ofrimin e mjedisit të përshtatshëm për investimet e huaja. Krahas kësaj, përmirësimi i administratës së tatimeve, është themelor për integrimin e Shqipërisë në Evropë.

Gazmir SPAHIJA

Drejtore i Përgjithshëm

Misioni

Misioni i administratës së tatimeve është të kontribuojë në mbulimin e shpenzimeve publike të qeverisë, përmes mbledhjes efektive dhe efikase të të ardhurave tatimore, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave.

Krahas kësaj, institucioni ynë siguron informacion, në mbështetje të hartimit të politikave ekonomike të qeverisë.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, administrata e tatimeve i asiston tatimpaguesit me shërbime të cilësisë së lartë, në mënyrë që ata t'i përmbushin vetë detyrimet e tyre fiskale sipas legjislacionit. Në të njëjtën kohë, administrata tatimore vepron kundër atyre sjellja e të cilëve nuk është në përmbushje të kërkesave ligjore.

Vizioni

Vizioni ynë është që administrata shqiptare e tatimeve të jetë një organizatë e cila i përmbush standardet e administratave tatimore të cilësisë së lartë në mbarë botën, si

- ✓ Një institucion, që ofron shërbime tatimore cilësore, që e rrit ndërgjegjësimin tatimor në shoqëri, nxit pajtueshmërinë vullnetare përmes pagimit të tatimeve dhe taksave, me idenë për ta ulur barrën administrative mbi tatimpaguesit dhe për ta thjeshtuar administrimin e tatim-taksave,
- ✓ Një autoritet që i mbledh, inspekton dhe kontrollon me drejtësi detyrimet tatimore, duke zbatuar me forcë ligjin dhe duke luftuar ekonominë informale dhe evazionin, në mbrojtje të të ardhurave fiskale,
- ✓ Një organizatë që respektohet nga shoqëria, që e ruan dhe e përshtat strukturën dhe vlerat e saj organizative, përmes përshtatjes ndaj ndryshimeve ekonomike dhe sociale, duke përdorur mjetet dhe metodat e teknologjisë më të përparuar si edhe duke bashkëpunuar me shoqatat e biznesit dhe me shoqërinë civile, autoritetet tatimore të shteteve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare,
- ✓ Një agjensi publike, që e përmbush misionin e vet, duke e përmirësuar veten dhe duke e formuar personelin e saj në vazhdimësi.

Vlerat

Vlerat e forta e rrisin besimin dhe mbështetjen që ka komuniteti i tatimpaguesve, për mënyrën se si e administrojmë sistemin tonë tatimor. Vlerat tona mbështeten:

Te besimi i tatimpaguesve

E rrisim besimin e komunitetit të tatimpaguesve përmes rritjes së zotësive tona profesionale, përmes reagimit ndaj problemeve të tyre, përmes rritjes së transparencës ditë pas dite, përmes trajtimit me drejtësi, barazi dhe ndershmëri të tatimpaguesve, përmes ruajtjes së niveleve të larta të integritetit moral, si edhe përmes nxitjes së kulturës së respektit reciprok.

Te zbatimi i normave të etikës dhe të luftës kundër korrupsionit

E zbatojmë me forcë ligjin, sipas standardeve etike të administratës sonë, me tolerancë zero kundër korrupsionit, sepse kjo mënyrë administrimi u jep tatimpaguesve garanci për drejtësinë dhe siguri.

Te mbështetja te tatimpaguesit

Mbështetemi te tatimpaguesit, te kontributi i profesionistëve në fushën e financave dhe tatimeve dhe te ndërmjetësit e tjerë të zbatimit të ligjit, të cilët kërkojnë të veprojnë drejt, duke punuar me ta përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit dhe duke u mbështetur te parimi i pajtueshmërisë vullnetare.

Te raportimi

Jemi transparentë në raportimin e aktiviteteve tona dhe në marrjen e mendimeve të publikut për çështjet e menaxhimit të riskut. I dëgjojmë dhe reagojmë mendimet e tatimpaguesve. Do të marrim hapa të mëtejshëm për t'i ndihmuar tatimpaguesit ta rrisin nivelin e njohurive dhe përbushjes së detyrimeve ligjore, si edhe për të punuar drejt uljes së kostove administrative për biznesin dhe për DPT-në.

Kuadri ligjor

Gjatë zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, administrata tatimore vepron me drejtësi dhe garanton respektimin e të drejtave të tatimpaguesve dhe të parimit të barazisë përpara ligjit. Administrata tatimore bën çdo përpjekje për të siguruar barazi në zbatimin e politikave fiskale të qeverisë. Administrata tatimore vepron në përputhje me kuadrin ligjor dhe me parimet e etikës administrative, me qëllim mbrojtjen e jetës private dhe të drejtave të individëve dhe bizneseve.

Ligji i procedurave tatimore dhe ligjet, objekti i të cilave janë tatimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe taksat kombëtare përbëjnë bazën mbi të cilën ngrihet kuadri i detyrueshëm ligjor për administrimin e tatimeve.

Qëllimet strategjike për periudhën 2012-2015 janë:

- 1. Mbledhja e tatimeve në përputhje me ligjin, për të mbështetur programet e qeverisë;**
- 2. Përmirësimi i shërbimeve të tatimpaguesve, për të mbështetur pajtueshmërinë vullnetare të detyrimeve ligjore tatimore dhe për t'i ulur kostot e tatimpaguesve dhe të administratës tatimore;**
- 3. Identifikimi dhe ndëshkimi i evazionit tatimor;**
- 4. Zhvillimi i një administrate tatimore efikase, e cila përmbush standardet e BE-së për administrimin e tatimeve;**
- 5. Përgatitja për anëtarësimin në BE, duke përmbushur angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet tatimore ndërkombëtare dhe duke marrë pjesë në dialogjet tatimorë ndërkombëtarë më të rëndësishëm.**

Për arritjen e këtyre synimeve strategjike do të punohet gjatë periudhës katërvjeçare dhe në vijim jepet më shumë hollësi për to. DPT-ja e shqyrton planin e vet strategjik çdo vit, për t'i përshtatur prioritetet, nëse është nevoja, për të pasqyruar rrethanat e ndryshuara apo mundësitë e reja për përmirësim.

Çdo vit, dpt përgatit një plan Operacional pune, ku paraqet se si do të punohet për qëllimet gjatë vitit në vijim. Strategjia e Pajtueshmërisë është dokument më vete, por për rëndësinë që ka shoqëron planin strategjik. Plani strategjik, do të publikohet në faqen zyrtare të DPT në inetrnet bashkë me pjesët kryesore të dokumentit të Planit të Pajtueshmërisë.

Plani operacional i DPT për vitin 2012 që do të hartohet në zbatim të objektivave të parapara të planit strategjik është shoqërues i planit të pajtueshmërisë, si një dokument më vete.

QËLLIMI 1 - Mbledhja e tatimeve në përputhje me ligjin, për të mbështetur programet e qeverisë

Objektivat

Përmirësimi i mbledhjes së detyrimeve tatimore duke siguruar rritjen e tatimeve të paguara brenda afateve, në bazë të deklarimit brenda afatit dhe me ndershmëri dhe saktësi sa u takon vlerave të mbajtura në burim, të deklaruar dhe të paguara

Zvogëlimi i borxhit tatimor

Brenda vitit 2012, të shqyrtohen masat organizative dhe kriteret e riskut për rimbursimin e TVSH-së në mënyrë që kërkesat e reja të përpunohen më shpejt

Perditesimi i regjistrit kombëtar tatimor për të shmangur keqmenaxhimin e burimeve si dhe përmirësimi i deklarimit në kohë me rritjen e cilësisë së regjistrit.

Strategjitë kryesore

Hartimi dhe zbatimi i metodave të reja të mbledhjes dhe menaxhimit të borxhit në kuadër të strategjisë së re të përmbushjes. Zbatimi fillon brenda vitit 2012

Te filloj përmes identifikimit dhe ndjekjes të gjithë atyre që nuk kanë kërkuar të përfitojnë nga amnisiata fiskale e vitit 2011, në një projekt në mbare vendin i cili të fillojë në vitin 2012
Zgjerimi me profile të reja i programit të mbledhjes së borxhit sipas një risku të caktuar me përparësi mbledhjen e borxhit me moshe të re

Të shqyrtohet praktika e rimbursimit dhe kreditimit të TVSH-së në vitin 2012 dhe të bëhen ndryshime duke filluar në vitin 2013

Shqyrtimi i regjistrit kombëtar duke e profilizuar sipas sektorëve ekonomikë dhe zonave gjeografike. Përshtetimin e kalimit të tatimpaguesve që kanë pushuar aktivitetin e tyre në regjistrin pasiv, mbështetur dhe në metodat e përdorura në projektin pilot të vitit 2011.
Përmirësimi i deklarimit dhe pagimit në kohë në 90% gjatë katër vjetëve të ardhshme

Rezultati i dëshiruar

Një sistem tatimor më pak i ndjeshëm në aktivitetin e tatimpaguesve, ku deklaratat tatimore depozitohen dhe pagesat bëhen kohë

Një sistem i cili mbështetet fuqimisht në parimet e pajtueshmërisë vullnetare dhe i cili konsiderohet si i drejtë

Një klimë më e mirë biznesi në të cilën sistemi tatimor e mbështet biznesin dhe mund të reagojë brenda një kohe të arsyeshme ndaj kërkesave që lidhen me vendimet për investime

Zvogëlim i kostove për bizneset dhe për administratën tatimore

QËLLIMI 2 - Përmirësimi i shërbimeve të tatimpaguesve, për të mbështetur pajtueshmërinë vullnetare të detyrimeve ligjore tatimore dhe për ti ulur kostot e tatimpaguesve dhe të administratës tatimore

Objektivat

Përmirësimi i nivelit të mirëkuptimit reciprok ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore

Hartimi i një modeli informativ elastik dhe efikas i tatimpaguesve në mënyrë që tatimpaguesit t'i njohin detyrimet e tyre tatimore dhe si ti përmbushin ato

Rritje e ndërgjegjesimit tatimor dhe ndihmën ndaj individët në depozitimin e deklaratave tatimore në 2012

Mbështetje e fuqishme për përpjekjet e tatimpaguesve të mëdhenj dhe të mesëm për t'i përmbushur detyrimet tatimore

Strategjitë kryesore

Rritja e marrëdhënieve me profesionistët fiskalë dhe shoqatat që perfaqesojnë grupe biznesi. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të propozohet përmirësimet e legjislacionit dhe procedurat tatimore për të hartuar një program 4 vjeçar të thjeshtimit tatimor për të ulur kostot e biznesit dhe administratës tatimore

Të konsultohen grupet e tatimpaguesve se si të përmbushen më mirë nevojat e tyre për informacion lidhur me përmbajtjen dhe kanalet e komunikimit.

Të vlerësohet kërkesa për vendime të mira tatimore dhe të zbatohet një shërbim.
Të vazhdohet me zhvillimin e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
Të ndihmohen dhe nxiten individët që e kanë për herë të parë depozitimin e deklaratave tatimore në vitin 2012

Rezultati i dëshiruar

Rritje e nivelit të pajtueshmërisë së kërkesat ligjore në mënyrë vullnetare
Përmirësim të legjislacionit dhe procedurave tatimore për të ulur kostot dhe kompleksitetet
Rritja e frekuentimit të faqes zyrtare në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit

Rritje e nivelit të deklarimit online

QËLLIMI 3 – Identifikimi dhe ndëshkimi i evazionit tatimor

Objektivat

Zvogëlimi i boshllëkut tatimor

Strategjitë kryesore

Hartimi i një strategjie të pajtueshmërisë, sipas normave të BE-së, gjatë vitit 2012 dhe zbatimi i saj me faza.

Përmirësimi i kapacitetit të analizës së riskut

Përdorim më i madh i informacionit nga të tretët, me fuqizim të teknologjisë të informacionit në DPT

Profilimi i kontrolleve me projekte tematike në baze të risqeve specifike në sektore ose rajone

Zbatim i masave më të mira për tatimin e individëve me risk të lartë, duke filluar me evidentimin dhe hetimin për individë me aktive dhe likujditete që janë objekt i ligjit të parandalimit për pastrim parash, nga ILDKP dhe ligjit antimafia

Shqyrtim i qasjeve të vendeve të BE-së në lidhje me vetëkontrollin dhe dhënien vullnetare të informacioneve, me zbatimin e këtyre koncepteve për risqe specifike apo tatimpagues specifik dhe bërja e rekomandimeve Ministrisë së Financave për ta vënë në zbatim një sistem të tillë përmes kuadrit të duhur ligjor.

Zvogëlimi i ekonomisë informale përmes zgjerimit të bazës tatimore

Rezultati i dëshiruar

Ulje e nivelit të evazionit fiskal dhe një sistem tatimor më i drejtë

Zvogëlim i ekonomisë informale

Rritje e të ardhurave tatimore, për zhvillimin kombëtar

Rritje e moralit qytetar në një shoqëri ku çdo njeri është i gatshëm të paguajë detyrimet tatimore.

QËLLIMI 4 – Zhvillimi i një administrate tatimore efikase e cila përmbush standardet e BE-së për administrimin e tatimeve

Objektivat

Të bëhet pajtueshmeria tatimore më pak e kushtueshme për bizneset, duke mbrojtur në të njëjtën kohë të ardhurat e shtetit

Rritja e efikasitetit të operacioneve të administrates tatimore

Një personel më profesionist me integritet dhe etike profesionale.

Strategjitë kryesore

Ekspertiza dhe propozimi per thjeshtimin e procedurave tatimore duke përdorur si model Fiscal Blueprint te BE-së, dhe dialogun me shoqatat e biznesit, avokatin e tatimpaguesve, dhe Keshillin Konsultativ Tatimor

Projektimi dhe zbatimi brenda vitit 2015 i sistemeve të reja të teknologjisë informatike që janë duke u planifikuar
Ristrukturimi i DP-së për ti menaxhuar më mirë ndryshimet e planifikuara gjatë periudhës së këtij plani

Shqyrtim dhe përmirësim i organizimit të drejtimit të brendshëm, duke përfshirë edhe drejtimin e brendshëm të TI-së

Strategji trajnimi e rishikuar që ndjek një qasje progresive dhe modulare për zhvillimin e aftësive teknike tatimore

Rezultati i dëshiruar

Koha që kërkon përmbushja e ligjeve tatimore, e matur sipas vrojtimit vjetor të Bankës Botërore, fillon t'i afrohet mesatares së BE-së
Rritje e të ardhurave tatimore ne permbushje te plote me ligjin e buxhetit te vitit

Ulje e kostos së administrimit në DPT. Analize me e mire risku dhe sherbime me te mira per tatimpaguesit

Rritje e kënaqjes së publikut nga DPT-ja, e matur sipas vrojtimeve periodike të sjelljes

QËLLIMI 5 - Përgatitja për anëtarësimin në BE, duke përmbushur angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet tatimore ndërkombëtare dhe duke marrë pjesë në dialogët tatimorë ndërkombëtarë më të rëndësishëm

Objektivat

Të sigurohet që administrata tatimore të luajë pjesën e vet në përgatitjen për anëtarësimin në BE

Pjesëmarrje në rrjetin e traktateve tatimore që kërkojnë investitorët ndërkombëtarë

Një personel më profesionist në administratën tatimore që është i njohur me çështjet tatimore ndërkombëtare

Strategjitë kryesore

Të punohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave për zbatimin e elementet tatimore të *acquis communautaire* të BE-së

Zbatimi i obligimeve që rrjedhin nga hartimi i traktateve përkatëse.

Të zhvillohen njohuritë teknike të brendshme për çështjet tatimore ndërkombëtare duke filluar me personelin e drejtorisë së tatimpaguesve të mëdhenj

Rezultati i dëshiruar

Miratim pa probleme dhe në kohë i *acquis communautaire* të BE-së në fushën e tatimeve

Personeli i njëj mirë çështjet tatimore ndërkombëtare dhe mund të merret pa probleme me bizneset globale